



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2020:138083
Datë: 03.05.2024
Numri i dokumentit: 05653355
C.nr.189/2020

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Avdulla Mecinaj, në çështjen kontestimore të paditëses Q.F. nga fshati..., komuna Gllogoc, të cilën e përfaqëson me autorizim av.H.H. nga Gllogoci, kundër të paditurës K... "E...", me seli ne Prishtinë, të cilën e përfaqësoj me autorizim përfaqësuesi V.A. nga Prishtina, për kompezimin e dëmit jo material dhe material, pas përfundimit te seancës kryesore publike me dt.08.04.2024, jep këtë.

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet pjesërisht kërkesëpadia e paditëses Q.F. nga fshati..., komuna Gllogoc, si e bazuar.

II. Detyrohet e paditura K... "E..." me seli Prishtinë, që në emër të kompensimit për aksidentin e dt:04.06.2019 t'i paguaj paditëses Q.F.:

Për dëmin jo material:

për dhimbje trupore- fizike shumen prej -----600 €,
për frike shumen prej-----500 €,

Në shumë të përgjithshme prej 1100 € me kamatë ligjore 8%, nga dita e gjykimit 08.04.2024 e deri ne pagesën definitive ne afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Për dëmin material:

për ndihmën nga personi tjetër shumen prej-----210 €,
për ushqim të përforcuar shumen prej ----- 200 €,
për rehabilitimin fizikal shumën prej -----105 €,

Në shumë të përgjithshme prej 515 € me kamatë ligjore 8%, nga dita e parashtrimit të padis dt:24.04.2020 e deri ne pagesën definitive ne afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. Refuzohet pjesa e kërkesëpadisë në me tepër se shumatat e gjykuara si në piken II si e pabazuar.

A r s y e t i m

Paditësja Q.F. përmes të autorizuarit ka parashtruar padi në këtë gjykatë me dt.24.04.2020, kundër te paditurës K... "E..." me seli në Prishtinë, për kompensimin e demit material dhe jo material që ka pësuar lëndime trupore dhe dëme materiale në aksidentin e trafikut rrugor me dt.04.06.2019 në fshatin... komuna Skenderaj.

I autorizuari i paditëses mbeti pranë padisë dhe kërkesë padisë duke e precizuar ne seancën kryesore kërkesën e padisë dhe ne fjalën përfundimtare deklaroi se paditësja ne cilësinë e pasagjeres ne aksidentin e trafikut rrugore qe ka ndodhur me dt:04.06.2019 ne rrugën lokale ne fshatin... ka pësuar lëndime trupore dhe dëme materiale, pra baza juridike nuk është kontestuese ashtu qe me precizimin e kërkesë padisë ne emër te demit jo material për shkak te dhimbjeve fizike për te gjitha llojet kërkojmë shumen prej 2000 euro, për shkak te frikës se përjetuar po ashtu për te gjitha llojet shumen prej 2000 euro, me kamat ligjore prej 8% nga data e gjykimit dhe ne emër te demit material për ushqimin e përforcuar shumen prej 300 euro, për ndihmën e personit tjetër shumen prej 420 euro dhe pre rehabilitimin fizioterapeotik shumen prej 150 euro, me kamat ligjore 8% nga data e parashtrimit te padisë 24.04.2020 e deri ne pagesën definitive, me arsyetim se gjate shqyrtimeve gjyqësore u provua se kërkesë padia e paditëses është e bazuar ligjërisht dhe e mbështetur me prova e cila ne cilësinë e pasagjeres ka pësuar lëndime trupore ne veturën e cila ishte shkaktuese e aksidentit dhe nga e paditura u ngritën një ser kundërshtimesh lidhur me faktin nëse paditësja ka qen pjesëmarrëse ne aksidentin e dt:04.06.2019 sipas numrit te rastit 2019BR288 por me provat e administruara me pa mëdyshje u vërtetua se e njëjta me te vërtet është lënduar ne ketë aksident, fakt se pari qe u provua nga raportet mjekësore te lëshuara ne ditën e njëjtë ne rastin e ndodhjes se aksidentit e po ashtu u provua edhe nga dëshmitaret e rastit te cilët me dëshmi te dhëna ne ketë shqyrtim gjyqësore ishin mjaft bindëse andaj gjykata edhe duhet tu jap besimin si prova te pranueshme andaj i propozomi gjykatës qe kërkesë padinë e precizuar ne tersi ta aprovoi si te bazuar duke e kërkuar shumen e përgjithshme prej 4930 euro, me kamat ligjore te cekur si ne precizim me propozim qe te aprovohet si e bazuar.

I kërkoj shpenzimet e procedurës kontestimore të precizuara pre hartimin e padisë shumen prej 104 euro, për ekspertize mjekësore shumen prej 300 euro, për 4 seanca nga 135 euro për një seance, e gjithsej shumen prej 944 euro, ndërsa për taks gjyqësore nuk kërkojmë për shkak se paditësja është anëtare e familjes se dëshmoreve.

Përfaqësuesi i të paditurës në seancat gjyqësore ne seancat gjyqësore deklaroi se me te gjithat provat materiale te administruara gjate shqyrtimeve gjyqësore pala paditëse nuk ka arritur ta vërtetoi faktin se paditësja ka qen pjesëmarrës ne ketë aksidenti pasi qe nuk është evidentuar ne raportin e policisë si pjesëmarrës ne ketë aksident apo si e lënduar, pasi qe ne baze te praktikës duhet ti besojmë vetëm raporteve zyrtare dhe atë raportet e policisë se Kosovës andaj i propozomi gjykatës qe kërkesë padinë e paditëses ta refuzoi ne tersi si te pa bazuar, pa u lëshuar ne çështjet tjera te cilat i kontestomi ne tersi.

Gjykata beri administrimin e provave, raporti i aksidentit nr.2019-BR-288 i dt.04.06.2019, raporti mjekësore nr.344666 i dt.04.06.2019, raporti specialistik i dt:05.06.2019, deklarimi i dëshmitareve O.G., A.M., I.A. dhe ekspertiza mjekësore C.nr.189/2020 e dt:27.03.2024.

Në kuptim të nenit 8 të LPK, pas analizimit dhe vlerësimit të gjithanshëm të deklaratave të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike.

Ne mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese fakti se aksidenti ka ndodhur me dt.04.06.2019 në rrugën lokale në fshatin..., komuna Skenderaj.

Për palën paditëse baza juridike e kërkesë padisë nuk është kontestuese me arsyetim se paditësja ka qene pjesëmarrëse në cilësinë e pasagjeres në aksidentin e trafikut, ndërsa e paditura e konteston bazën juridike për faktin se paditësja nuk ka qen e përfshirë në raportin e aksidentit si pjesëmarrëse.

Ne ekspertizën e hartuar me shkrim C.nr.189/2020 e dt:27.03.2024 e hartuar nga ekspertet gjyqësore Dr.N.D.- ortoped teumatolog dhe Dr. Sh.M. –psikiatër pas shqyrtimit dhe analizës së shkresave të lëndës në emër të Q.F. e lindur me dt:13.10.1992, e lënduar me dt:04.06.2019 në aksident komunikacioni në cilësinë e bashkudhëtares, kur vetura në të cilën ka qen është ndeshur me një veturë tjetër dhe me këtë rast ka pësuar lëndime trupore, si dhe ekzaminimit të drejtpërdrejt të dt:18.03.2024 kanë dhënë konstatimin se ka pësuar përdredhjen e qafës, shtypje të gjurit të djathtë, gjakderdhje në regjionin e gjurit të djathtë, dhe dëmtimet e cekura janë të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të forte dhe të furishëm mbretes (jo i mprehtë), dhe si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore dhe si pasojë e tyre paditësja ka pësuar dhimbje fizike me intensitet të rëndë 24 ore, me intensitet të mesëm 5 dite, me intensitet të ulët kanë qen dhe janë ende prezentë, frik primare e intensitetit posaçërisht të lart disa sekonda, frik sekondare e intensitetit të lart në kohëzgjatje 45 minuta, frika sekondare e intensitetit të mesëm në kohëzgjatje 2 jave dhe frika sekondare e intensitetit të ulët vazhdon, shëmtim trupor nuk ka, zvogëlim të aktivitetit jetësor nuk ka, ndihma e personit të tretë ka qen e nevojshme në kohëzgjatje 3 jave, ushqimi i përforcuar ka qen i nevojshëm për 3 jave dhe rehabilitimi fizioterapeutik dhe psikik ka qen i nevojshëm vitin e parë nga 7 dite.

Në shqyrtimin kryesorë dëshmitari O.G. deklaroi se pasi që është kohe e gjatë në këtë aksident ka qen e përfshirë edhe Q.F. mirëpo në momentin kur në kemi arritur si patrullë në vendin e ngjarjes dikush nga qytetaret i kanë transportuar të lënduarit për ndihmë mjekësore dhe sipas rregullës është afati 72 ore kur palët e dëmtuara mund të sjellin raportet mjekësore nëse kanë pësuar lëndime dhe në i evidentomi në raportin e aksidentit, mirëpo në rastin konkret jam i sigurt se kjo ka qene e përfshirë në aksident në cilësinë e pasagjeres dhe është e mundshme që na ka rrjedhur lëshimi teknik duke mos e evidentuar në raport, aksidenti ka ndodhur në fshatin..., komuna Skenderaj.

Në cilësinë e dëshmitarit A.M. ka deklaruar se aksidenti ka ndodhur në fshatin..., unë kam qen duke drejtuar veturën Golf 5, dhe ka ardhur deri të aksidenti, familjen time e kam drejtuar në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Skenderaj ,ndërsa në veturën tjetër kanë qene një grua dhe disa vajza nuk e di numrin e saktë të tyre dhe i kanë dërguar për në Drenas për ndihmë mjekësore.

Dëshmitari I.A. deklaroi se paditësja është vajza e motrës time dhe në ditën e aksidentit kanë qen në vizite familjare tek në dhe duke shkuar rrugës në fshatin... me kanë thirrur përmes telefonit, ku me kanë njoftuar se kanë pasur një aksident trafiku dhe i kishin dërguar në Drenas për ndihmë

mjekësore dhe Q. dhe L. kishin qen duke marrur infuzion pra e njëjta ka qen si pjesëmarrëse ne aksidentin e trafikut qe ka ndodhur me dt:04.06.2019 ne...

Gjykata i vlerësoi deklaratimet e dëshmitareve te cilët ne mënyre bindëse dëshmuuan se paditësja ka qene pjesëmarrëse ne cilësinë e pasagjeres ne aksidentin e trafikut ne te cilën paditësja ka pësuar lëndime trupore dhe dëme materiale, dëshmi te cilave gjykata u fali besimin e plote.

Me rastin e vlerësimit ne lartësinë e demit jomaterial dhe material, gjykata pati parasysht natyrën e lëndimeve trupore që ka pësuar paditësi dhe moshën e paditësit e duke u bazuar ne nenin 183 te LMD i Kosovës, në të cilin është përcaktuar se për dhimbje të pësuar fizike, për dhimbjet e përjetuara shpirtërore gjykata do te gjykoj kompensim te drejte në të holla.

Me nenin 10 te Ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia është përcaktuar se kompensimi i demit material dhe jomaterial behet në pajtim me dispozitat e LMD.

Pjesa e kërkesëpadisë në emër të përkujdesjes nga personi tjetër, ushqimit të përforcuar dhe rehabilitimit konsiderohet si e arsyeshme dhe gjykata me bindje të lirë e aprovoi këtë pjese të kërkesëpadisë duke u bazuar në kushtet dhe standardin jetësor në Kosovë, e në kuptim të nenit 323 të LPK i Kosovës.

Shumat e aprovuara në emër të dëmshpërblimit për demin jomaterial dhe material janë të arsyeshme e që paraqesja një satisfakcion që paditësi me këto mjete t'i riparoj në një mase nevojat e veta materiale e që për ndryshe nuk paraqesin kompensim absolut te dëmshpërblimit.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e palës se paditur se paditësja nuk ka qene e përfshire ne raportin e aksidentit, një pretendim i tille është i pa bazuar për faktin se bazuar ne deklaratimet e dëshmitareve dhe raportet mjekësore te cilat përputhen me datën e aksidentit dhe me ekspertizën mjekësore s e lëndimet e pësuar te paditëses janë pasoje e aksidentit janë te pa bazuara pasi qe është lëshuar gabim teknike qe nuk është e përfshirë ne raportin e aksidentit siç ndodhin rastet e tilla ne praktike.

Pjesa e kërkesëpadisë se precizuar mbi shumen e gjykuar në lartësi të cekura si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është refuzuar si e pabazuar si shume e cila tejkalon arsyshmërin e kompensimit

Gjykata në lartësinë e aprovuar si në dispozitiv paditësit ia njohu të drejtën me kamatë ligjore të cilën e paditura duhet ta përmbushi në kuptim të neneve 382 dhe 378 të LMD i Kosovës.

Vendimi për shpenzimet e procedurës kontestimore u bazua në nenin 452 te LPK, në të cilat shpenzime janë llogaritur për hartimin e padisë shumën prej 104 euro, për një ekspertizë mjekësore shumën prej 300 euro, dhe për 4 përfaqësime në seanca shumën 540 euro, e në shumë të përgjithshme 944 euro

Gjykata duke u bazuar në nenin 143 të LPK, vendosi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.189/2020 me dt.08.04.2024

Gjyqtari,
Avdulla Mecinaj

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së aktgjykimit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.